



Datë: 14.04.2025
Numër Protokolli: 3084/2025
A.nr. 426/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.426/2025, të datës 07.03.2025, të parashtruar nga ankuesi M.M, kundër organit të punësimit: Agjencia Pyjore e Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.426/2025, e datës 07.03.2025 e parashtruar nga ankuesi M.M.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil M.M (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 07.03.2025, përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Zyrës së Personelit të Agjencisë Pyjore të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.03.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia Pyjore e Kosovës (*tutje referuar APK*), ndërsa, kjo e fundit, më datë 19.03.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë, së bashku me provat materiale lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesi, është e parakohshme, **sepse**:

Nga shqyrtimi i provave të administruara rrjedhë së ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 02.05.2012, është i punësuar në pozitën *Shef i Sektorit për Pylltarisë*, në kuadër të Komunës së Lipjanit, mirëpo pas Memorandum Bashkëpunimit të datës 05.12.2023, të lidhur mes Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Komunës së Lipjanit, të gjithë rojet e pyllit, teknikat e pylltarisë dhe përgjegjësit e njësive komunale bashke me mjetet buxhetore, automjetet

dhe pajisjet tjera si dhe mjetet përkatëse funksionale që lidhen me përgjegjësitë dhe detyrat e ndryshme pyjore janë transferuar në Agjencinë Pyjore të Kosovës, në këtë rast edhe ankuesi.

Tutje sipas shkresave të lëndës del se ankuesi më datë 05.02.2025, i është drejtuar me kërkesë Njesisë së Burimeve Njerëzore të APK-së, me të cilën ka kërkuar: harmonizimin e koeficientit në nivel të njëjtë me të gjitha ata që kanë pozita të njëjtë shef apo përgjegjës i njesisë në APK; Kompensimin në pagë nga muaji shkuar 2024 deri tani për 0.11 të koeficientit; Rregullimin për përvojë pune bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese nga 0.25% në 0.5%.

Ankuesi më datë 07.03.2025, parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime së i janë cenuar të drejtat e tij lidhur me pagës, duke shtuar së ka qenë në marrëdhënie punë në Komunën e Lipjanit dhe së i njëjti ka realizuar koeficient 7.24, ndërsa, pas transferimit në APK ka realizuar koeficient të pagës 7.35, nga janari 2025 koeficienti i pagës është 7.74, e që sipas ankuesit do të duhej të ishte 7.85. Kërkon harmonizimin e koeficientit në nivel të njëjtë me të gjitha ata që kanë pozita të njëjtë shef apo përgjegjës i njesisë në APK; Kompensimin në pagë nga muaji shkuar 2024 deri tani për 0.11 të koeficientit, rregullimin për përvojë pune bazuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nga 0.25% sa e kam aktualisht në 0.5% siç parashihet me këtë aktgjykim.

Kolegji i Këshillit në kuptim të pranushmerisë së ankesës së ankuesit iu referua Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, më konkret nenit 98 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet se: **1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj,** si dhe nenit 127 paragrafi 1 dhe 4 i të njëjtët ligj ku përcaktohet se: **“1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ...”** e në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.03.2025 është e parakohshme, pasi që ankuesi ende pa kaluar afati ligjor për përfundimin e procedurës administrative të iniciuar sipas kërkesës së datës 05.02.2025 dhe rrjedhimisht ende pa u përmbushur kriteri kohor lidhur me heshtjen administrative parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Andaj, mbi këtë bazë konstatimi, Kolegji vlerëson se ankesa e ankuesit është papranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që, bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.426/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit M.M;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në APK; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.